Јавна општинска установа за деца
Institucioni publik komunal-kopshti për fëmijë

Бр./Nr. 04-284/1
13.11 20 26 год./viti
с.Пршовце, Теарце, f.Përshefcë, Tearcë

Në bazë të nenit 143 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 23/2013 ,12/2014, 44/2014, 144/2014, 10/2015, 25/2015, 150/2015, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 , 104/19 , 146/19 , 275/19 , 311/20, 294/21, 150/22, 236/22, 17/25 dhe 132/25) dhe pëlqimit të Ministrisë së finansave nr. 19-2568/2 të datës 07.04.2026, U.D Drejtori I IPKKF "Foleja" fsh. Përshefcë , Komuna e Tearcës shpall

SHPALLJE PUBLIKE nr.5/2026

Për punësim të dhënësve të shërbimeve në kohë të pacaktuar pune

1. Tre (3) persona në vend pune – përkujdesëse-ndihmës punëtor profesional – praktikant - dhënës I shërbimeve niveli D4 në kohë të pa caktuar pune me shifër DEZ 03 03 D04 001;
2. Dy (2) persona në vend pune – edukatore për fëmijë prej moshës 2-6 vjeç - praktikant– dhënës i shërbimeve niveli V4 në kohë të pacaktuar pune me shifër DEZ 03 03 V04 001;

Kushtet e përgjithshme që vlejnë për të gjithë kandidatët:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Të jetë i shëndoshë fizikisht dhe psiqikisht:
- Të njeh gjuhën maqedone dhe alfabetin kirilik;
- Të mos i është shqiptuar dënim apo sanksion për kundërvajtje prë ushtrim të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- Të mos i është shqiptuar dënim apo vendim gjyqësor ku personi është i dënuar me vepër penale për dhunë në familje, marrjen e të miturit, neglizhencës dhe keqtrajtimit të një të mituri ose incest, për një vepër penale nga grupi i akteve kundër lirisë gjinore, pavarësisht nga sanksioni i shqiptuar dhe në të cilën është vendosur sjellja diskriminuese në përputhje me ligjin.
- Të përmbush edhe kushtet tjera të përcaktuara me aktin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Përveç kushteve të përgjithsme të cilat vlejnë për të gjithë kandidatët , për çdo vend pune duhet të plotëësohen edhe kushtet e veçanta edhe atë:

1. **Për vendin e punës përkujdesëse-ndihmës punëtor profesional - praktikant – dhënës I shërbimeve niveli D4 me shifër DEZ 03 03 D04 001:**

- Niveli D3 – shkollë e mesme katërvjeçare : shkollë e mesme medicinale , shkollë e mesme – gjimnaz , shkollë e mesme muzikore , shkollë e mesme e artit figurativ , shkollë e mesme e edukatës fizike , licencë të vlefshme për përkujdesëse , me ose pa përvojë pune në profesion.

-Orari i punës ditore është i lëvizshëm nga ora 08:00-16:00 ose prej 11.00 deri më 19:00 nga të cilat 7 orë punë në grup me fëmijë.
-Rroga bazë neto për këtë vend pune është : 31.600,00 denarë.

1. **Për vendin e punës edukatore për fëmijë prej moshës 2-6 vjeç - praktikan dhënës i shërbimeve niveli V4 me shifër DEZ 03 03 V4 001:**

- Niveli V4 – edukatore për fëmijë prej moshës 2 deri më 6 vjeç, gjegjësisht deri në fillim shkollës fillore (profesor i diplomuar për edukim parashkollor , edukatore e diplomu për fëmijë të moshës parashkollore , pedagog i diplomuar për edukim parashkollor d pedagog i diplomuar) , me 240 kredi sipas sistemit EKTS dhe të ketë mbaruar shkoll të lartë VII-1 niveli dhe të ketë licencë të vlefshme për edukatore ,me ose pa përvo pune në profesion.

-Orari i punës ditore është i lëvizshëm nga ora 07:00-15:00 ose prej 10.00 deri më 18:0 nga të cilat 6 orë punë në grup me fëmijë.
-Rroga bazë neto për këtë vend pune është : 36.991,00 denarë.

Kandidatët të cilët do të aplikojnë në shpalljen publike duhet të dorëzojnë këto dokumente:

1. Lutje(të potencohet se përcilin vend pune aplikon dhe të ketë numër kontakt telefoni);
2. Vërtetim për nënshtetësinë;
3. Vërtetim se e njeh gjuhën maqedone dhe alfabetin kirilik;
4. Vërtetim për arsimin e kryer;
5. Licencë e vlefshme për përkujdesëse (nëse aplikoni për vendin nr.1) , Licencë e vlefshme për edukatore (nëse aplikoni për vendin nr.2).
6. Çertifikatë mjeksore (nga dispanzer I mjekësisë së punës);
7. Dëshmi nga Gjykata se nuk është shqiptuar dënim apo sanksion për kundërvajtje për ushtrim të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
8. Dëshmi nga Gjykata se nuk është shqiptuar dënim apo vendim gjyqësor ku personi është i dënuar me vepër penale për dhunë në familje, marrjen e të miturit, neglizhencës dhe keqtrajtimit të një të mituri ose incest, për një vepër penale nga grupi i akteve kundër lirisë gjinore, pavarësisht nga sanksioni i shqiptuar dhe në të cilën është vendosur sjellja diskriminuese në përputhje me ligjin.

Shpallja zgjat 5 ditë pune prej ditës së shpalljes. Kandidatët duhet të sjellin lutje bashkë me dokumentet e aplikimit. Dokumentet e nevojshme për aplikim në shpallje duhet të jenë origjinale apo kopje të noterizuar. Dokumentet e jokompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni për punësime. Përzgjedhja do të bëhet në afat prej 45 ditëve.

Kandidatët e interesuar aplikimet mund t'i dorëzojnë në arkivin e IPKKF "Foleja" fsh. Përshefcë, Komuna e Tearcës në rr. 101 nr. Pn, apo nëpërmjet postës me mbishkrim "Për shpalljen publike për punësim nr.5/2026" rr. 101 nr. pn, Përshefcë, Komuna e Tearcës.

IPKKF "Foleja" fsh. Përshefcë, Tearcë
U.D Drejtor
Isnisha Veli Farizi